2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Zyrën e Kryeministrit me kod 104, në nën-programin "Zyra e Kryeministrit" me kod 10600, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, të Seksionit 2.8 të Marrëveshjes së Sfidave të Mijëvjeçarit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të datës 15 korrik 2022, të Listës E të Marrëveshjes për Zbatimin e Programit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës të datës 15 korrik 2022, të nenit 4.2 pika (k) të Marrëveshjes për Zhvillimin e Kompaktit të datës 18 tetor 2019, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 10,000.00€ (dhjetë mijë euro), për rimbursimin e tatimeve të ndryshme të paguara nga Fondet e Kompaktit, ashtu siç është e definuar në Marrëveshjen e Sfidave të Mijëvjeçarit, apo nga Fondet për Zhvillimin e Kompaktit, ashtu siç është e definuar në Marrëveshjen për Zbatimin e Programit.

1. Mjetet buxhetore do të përdoren për rimbursimin e tatimit në pronë, tatimit në regjistrimin e veturave, tatimit në automjete, tatimit rrugor, taksën për regjistrimin e automjeteve dhe tatimet tjera që nuk janë të liruara drejtpërdrejtë e të cilat paguhen nga Fondet e Kompaktit apo Fondet për Zhvillimin e Kompaktit.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 08/1-260 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kursime dhe ndarje, sipas tabelave të bashkangjitura në aneksin A (Kursimet) dhe në aneksin B (Ndarjet).

2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Aneks A (Kursimet)

BLLOKU_KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	Kursime
10/205/50400/30/18987/0650	MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFI	DEPARTAMENTI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	18987	PROGRAMI I BANIMIT SOCIAL	5,000,000.00
10/206/11306/30/14123/0721	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	ADMINISTRATA QENDRORE - MSH	14123	FAZA E I- RE E NDERTIMIT TE QEND. EM	5,617,000.00
10/206/72100/30/10997/0750	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	PROGRAMET TJERA	10997	ZHVILLIM I SISH-IT	2,626,982.00
10/215/33600/30/19316/0340	MINISTRIA E DREJTËSISË	SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS	19316	RENOVIMI I OBJEKTEVE TË QENDRËS S	1,200,000.00
10/215/33600/30/19319/0340	MINISTRIA E DREJTËSISË	SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS	19319	NDERTIMI I OBJEKTIT TE PUNETORIVE	1,300,000.00
10/201/11301/30/11286/0112	MINISTRIA E FINANCAVE, PUNË	ADMINISTRATA QENDRORE - MF	11286	NDERTIMIN I OBJEKTIT TE ATK-DOGA	1,500,000.00
10/201/11301/30/13616/0133	MINISTRIA E FINANCAVE, PUNË	ADMINISTRATA QENDRORE - MF	13616	ZHVILLIMI I SISTEMIT PËR DEPONIMIN	2,144,209.00
10/612/16302/30/54308/0133	FUSHË KOSOVË	ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË	54308	BLERJA E INVENTARIT PER KATIN SHTE	4,095.00
10/612/18002/30/54227/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54227	MBJELLJA E PEMËVE DEKORATIVE, DH	1,010.00
10/612/18002/30/54306/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54306	ASFALTIMI NE SLLATINË TË VOGËL:RR	880.00
10/612/18002/30/54342/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54342	ASFALTIMI NË VRAGOLI RRUGA VAKU	776.00
10/612/18002/30/54343/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54343	ASFALTIMI NË MIRADI E EPËRME:RRUG	162.00
10/612/18002/30/54347/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54347	ASFALTIMI NË HENC : RRUGËT LIQENI,	369.00
10/612/18002/30/54374/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54374	ASFALTIMI NË KUZMIN RRUGA ,TOZA N	750.00
10/612/18002/30/54376/0451	FUSHË KOSOVË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54376	ASFALTIMI NË MIRADI TË POSHTME: RR	3,136.00
10/612/18162/30/54200/0451	FUSHË KOSOVË	INFRASTRUKTURA PUBLIKE - FUSHË KOSOVË	54200	NDËRTIMI I KANALIZIMEVE DHE UJËSJ	2,005.00
10/612/18162/30/54204/0451	FUSHË KOSOVË	INFRASTRUKTURA PUBLIKE - FUSHË KOSOVË	54204	RIPARIMI I RRUGËVE TE ASFALTUARA	11,594.00
10/612/18162/30/54206/0451	FUSHË KOSOVË	INFRASTRUKTURA PUBLIKE - FUSHË KOSOVË	54206	SHENJËZIMI HORIZONTAL DHE VERTIK	10,030.00
10/612/73150/30/54224/0721	FUSHË KOSOVË	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËS	54224	BLERJA E INVENTARIT PER QMF RRUGA	16,582.00
10/612/73150/30/54234/0721	FUSHË KOSOVË	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËS	54234	PAISJE MJEKSORE PER QKMF : MIKROS	4,610.00
10/612/93030/30/54299/0912	FUSHË KOSOVË	ARSIMI FILLOR - FUSHË KOSOVË	54299	RENOVIMI I OBJEKTEVE SHKOLLORE- "	415.00
10/624/18012/30/54153/0451	SUHAREKË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54153	NDERTIMI I SHESHIT BRIGADA 123 NE Q	80,771.00
10/624/18012/30/54160/0451	SUHAREKË	SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRU	54160	NDERTIMI I IMPLANTIT PER UJERA TE ZI	40,097.00
10/633/19585/30/54862/1090	ISTOG	ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - ISTOG	54862	ASFALTIMI I RRUGËS AVDO MEJZEDOV	8,522.00
10/633/66090/30/54983/0620	ISTOG	PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV	54983	NDËRTIMI I PARQEVE DHE INFRASTRUK	51,000.00
10/633/93480/30/54762/0912	ISTOG	ARSIMI FILLOR - ISTOG	54762	RENOVIMI I KULMIT DHE HYRJES SE SH	1,065.00
10/642/48022/30/54785/0411	MITROVICË	PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - MI	54785	ZGJERIMI I RRJETIT TË NDRIQIMIT PUBI	30,000.00
10/642/48022/30/54789/0411	MITROVICË	PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - MI	54789	NDËRTIMI I RRUGEVE DHE TROTUAREV	40,000.00
10/642/48022/30/54791/0411	MITROVICË	PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - MI	54791	ASFALTIMI, RIPARIMI DHE RREGULLIM	20,000.00
10/642/85022/30/54684/0820	MITROVICË	SHËRBIMET KULTURORE - MITROVICË	54684	BLERJA DHE MONTIMI I SEMAFORIT NE	20,000.00
10/642/85022/30/54802/0820	MITROVICË	SHËRBIMET KULTURORE - MITROVICË	54802	PJERRTESORE PER PERSONAT ME AFTE	10,000.00
10/642/92110/30/53082/0980	MITROVICË	ADMINISTRATA - MITROVICË	53082	RREGULLIMI I OBJEKTIT GJIMNAZIT FR	36,000.00
10/642/92110/30/53089/0980	MITROVICË	ADMINISTRATA - MITROVICË	53089	NDËRTIMI I ÇERDHËS PËR FËMIJË NË F	70,000.00
10/642/92110/30/53107/0980	MITROVICË	ADMINISTRATA - MITROVICË	53107	RREGULLIMI I OBJEKTIT SHMLT "ARKI	50,000.00
10/642/92110/30/53112/0980	MITROVICË	ADMINISTRATA - MITROVICË	53112	BLERJA E TABELAVE DIGJITALE NË SH	35,000.00
10/642/92110/30/53113/0980	MITROVICË	ADMINISTRATA - MITROVICË	53113	NDËRTIMI I PALESTRËS SË SPORTEVE N	20,321.00
10/642/92110/30/54475/0980	MITROVICË	ADMINISTRATA - MITROVICË	54475	NDËRTIMI I ÇERDHES PËR FËMIJË NË LA	70,000.00
Total -Kursime në Shpenzime Kapitale					20,027,381.00
Total - Kursime					20,027,381.00

Aneks B (Ndarjet)

BLLOKU_KODUES	ORGANIZATA	PROGRAMI	KAT	KATEGORIA	Ndarje
10/214/30000/11/00000/0310	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	SHËRBIMET ADMINISTRATIVE	11	PAGA DHE SHTESA	8,687,328.00
10/224/11324/11/00000/0133	FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR	ADMINISTRATA E FONDIT TË SIGURI	11	PAGA DHE SHTESA	6,937.00
10/239/22900/11/00000/0490	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT	ADMINISTRATA QENDRORE - AKP	11	PAGA DHE SHTESA	103,909.00
10/243/23800/11/00000/0330	GJYKATA KUSHTETUESE	GJYKATA KUSHTETUESE	11	PAGA DHE SHTESA	2,286.00
10/317/45400/11/00000/0454	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	11	PAGA DHE SHTESA	30,514.00
10/612/93030/11/00000/0912	FUSHË KOSOVË	ARSIMI FILLOR - FUSHË KOSOVË	11	PAGA DHE SHTESA	631,653.00
10/615/93120/11/00000/0912	PODUJEVË	ARSIMI FILLOR - PODUJEVË	11	PAGA DHE SHTESA	304,209.00
10/623/93300/11/00000/0912	RAHOVEC	ARSIMI FILLOR - RAHOVEC	11	PAGA DHE SHTESA	472,160.00
10/624/93330/11/00000/0912	SUHAREKË	ARSIMI FILLOR - SUHAREK	11	PAGA DHE SHTESA	284,387.00
10/631/93420/11/00000/0912	DEÇAN	ARSIMI FILLOR - DEÇAN	11	PAGA DHE SHTESA	507,302.00
10/633/93480/11/00000/0912	ISTOG	ARSIMI FILLOR - ISTOG	11	PAGA DHE SHTESA	86,944.00
10/635/93540/11/00000/0912	PEJË	ARSIMI FILLOR - PEJË	11	PAGA DHE SHTESA	1,304,352.00
10/642/93630/11/00000/0912	MITROVICË	ARSIMI FILLOR - MITROVICË	11	PAGA DHE SHTESA	401,321.00
10/643/93660/11/00000/0912	SKENDERAJ	ARSIMI FILLOR - SKËNDERAJ	11	PAGA DHE SHTESA	321,822.00
10/651/93780/11/00000/0912	GJILAN	ARSIMI FILLOR - GJILAN	11	PAGA DHE SHTESA	413,821.00
10/653/93840/11/00000/0912	KAMENICË	ARSIMI FILLOR - KAMENICË	11	PAGA DHE SHTESA	703,334.00
10/657/93960/11/00000/0912	VITI	ARSIMI FILLOR - VITI	11	PAGA DHE SHTESA	684,278.00
10/657/95160/11/00000/0922	VITI	ARSIMI I MESËM - VITI	11	PAGA DHE SHTESA	80,824.00
Total Ndarje në Paga dhe Shtesa					**15,027,381.00**
10/214/30400/13/00000/0310	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	SHËRBIMET E MBESHTETJES	13	MALLER DHE SHERBIME	5,000,000.00
Total Ndarje në Mallera dhe Shërbime					**5,000,000.00**
Total - Ndarje					**20,027,381.00**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 6,624,701.00€ (gjashtë milionë e gjashtëqindenjëzetekatër mijë e shtatëqindenjë euro), në kuadër të Masës 4.6-Mbështetja e Ndërmarrjeve Publike, në Pakon e Ringjalljes Ekonomike.

2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në nën-programin me kod 11313, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohet Ministria e Ekonomisë që mjetet nga pika 1. e këtij vendimi t'ia transferojë ndërmarrjes publike KOSTT Sh. A. për përmbushjen e obligimeve ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit - Shqipëri dhe Korporata Elektroenergjitike Shqiptare - KESh.

4. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij vendimi përcaktohen me marrëveshje që lidhet në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe KOSTT Sh. A.

5. Mjetet sipas këtij vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) te organizata buxhetore dhe programi përkatës.

6. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit për nevoja të Terminaleve Doganore:

   - Terminali Doganor Hani i Elezit, Komuna Hani i Elezit; dhe
   - Terminali Doganor Dheu i Bardhë, ZK. Domoroc, Komuna Ranillugë, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.

3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.

4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislacionit në fuqi.

8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.

9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 25/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve dhe Republikës së Kroacisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punës, Sistemit Pensional, Familjes dhe Politikave Sociale.

2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 26/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes për Sigurime Sociale ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale për Çështje Sociale, Shëndetësi, Kujdes dhe Mbrojtje të Konsumatorit".

2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafit 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin "Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0"

2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 28/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë për vitin 2023.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 29/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Shtetërore për Sport 2025-2030 dhe Plani i Veprimit 2025-2027.

2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 30/233
Datë: 27.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 11, paragrafit 12. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për ndarje të mjeteve buxhetore në shumë prej 150,000€ (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) për realizimin e projektit përmes marrëveshjeve me Trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me Trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim me kod 211, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 1131, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Tranfere".

3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë